# DËSHMI ARKIVI

**A-469629**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Denoncimi nga Infektivi: "Nuk ka vigona, serumin po ua bëjnë me gjilpërë" |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394132.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 16:55:36 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 25 shtator 2026, 16:42:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 25 shtator 2026, 16:41:00 UTC → 25 shtator 2026, 16:43:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `cc577d3aac4acd064569c09a653d3bd9de9b140c07017624d2d02dbcd88c620a` |
| TEKSTI | `2b59dae17b8558a340e191d3d036b8c994d72018a83599390a104c4ba55b59eb` |
| PAMJA | `f058b9cc4c436ef271b47b09118f0fec1a9142e269afb4d7d64bce4630aee5eb` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `3c503905a2070d4682547e8598a91224e60e739a5025efd18950f031d66387e0` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `96339b4c2dc892b32bb4ef058b3a026fd313b806f95d2de1cfb905f974369f65` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/3c503905a2070d4682547e8598a91224e60e739a5025efd18950f031d66387e0`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Denoncimi nga Infektivi: “Nuk ka vigona, serumin po ua bëjnë me gjilpërë”

Shkruar nga: Y Pepa | Publikuar më: 25.09.2026, 18:42





Një qytetar i është drejtuar redaksisë së **JOQ Albania** për të denoncuar një situatë që, sipas tij, po ndodh në **Spitalin Infektiv të Tiranës**, ku pretendohet se ka mungesë të vigonave për pacientët që marrin serum dhe mjekime intravenoze.

Sipas qytetarit, për shkak të mungesës së këtyre materialeve, disa pacientëve serumi po u vendoset përmes një **age të thjeshtë**, e cila fiksohet në venë me leukoplast.

Në videon e mbërritur në redaksi shihet krahu i një pacienti, ku duket një age e fiksuar me fashë, ndërsa tubi i serumit është i lidhur me të. Më pas, pamjet tregojnë ambientet e dhomës dhe shishen e serumit të vendosur në mbajtësen metalike.

> **"Përshëndetje JOQ, jemi te Spitali Infektiv i Tiranës dhe desha të denoncoj këtë rast. Nuk ka vigona për njerëzit që vijnë në spital. Serumin po ua bëjnë me age direkt, se nuk kanë vigona,"** shprehet qytetari në denoncimin e tij.

Shërbimi i Sëmundjeve Infektive është pjesë e **Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (QSUT)** dhe funksionon 24 orë, duke ofruar shërbim spitalor, diagnostikim dhe trajtim për sëmundjet infektive.

**JOQ Albania nuk mund të konfirmojë në mënyrë të pavarur nëse në momentin e regjistrimit të videos ka pasur mungesë të vigonave apo nëse mënyra e administrimit të serumit lidhet me mungesën e tyre.**

Për këtë arsye, redaksia i drejtohet **QSUT-së** për një sqarim mbi situatën dhe për të mësuar nëse ka pasur probleme me furnizimin me kanula intravenoze në Shërbimin Infektiv.

Qytetarët kërkojnë që materialet e nevojshme mjekësore të jenë në dispozicion të pacientëve dhe që çdo problem me furnizimin të zgjidhet sa më shpejt.



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.